

**AKT THEMELIMI
STATUTI I SHOQËRISË
“OXA ENTERPRISE”**

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007”Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit”, u vendos si më poshtë:

**KREU I
THEMELIMI, EMRI,OBJEKT,KOHËZGJATJA,SELIA**

**NENI 1
DATA E THEMELIT DHE EMRI I SHOQËRISË**

Sot më datë 08.04.2022 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**OXA ENTERPRISE**” shpk (në vijim referuar si “*Shoqëria*”).

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Besnik Hoxha** i biri i **Tetem-it**, lindur më 22.02.1984, në Berat dhe banues në Fshatin Donofrose,Nj.A Cukalat, Bashkia Dimal, shtetas Shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal **I40222006P**.

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Dhenie me qera, prodhim, montim, çmontim skele, importeksport.Suvatim,patinim dhe lyerje ne ndertim.

Punime ndertimi, tregti me shumice e pakice materiale ndertimi e te gjitha llojeve te mallrave te lejuara nga legjislacioni shqiptar per kete shoqeri.

Shitja dhe blerja e pajisjeve të Teknologjisë së informacionit të tilla si kompjutera, laptope, servera, projektore, kamera dixhitale, skaner, printera, fotokopje, fakse, etj. Krijimi i linjave për montimin e kompjuterave dhe studiove dixhitale.

Sigurimi i pjesëve të këmbimit për të gjitha llojet e pajisjeve të IT dhe realizimi i shërbimit të mirëmbajtjes, garancisë e të riparimit.

Realizimi i projektimit dhe instalimit të rrjeteve kompjuterike, informatike dhe mirëmbajtjen e tyre. Realizimi i projektimit, dhe instalimit të sistemeve të menaxhimit elektronik, elektrik dhe të sigurisë së ndërtesave. Programim programe implementim i sistemeve dhe programeve informatike (softëare-ve), mirëmbajtje sistemesh dhe programesh informatike, asistence dhe konsulencë për përgatitjen e programeve informatike(softëare-ve).

Përpunimi i të dhënave në kompjuter e pajisjete tjera me synim realizimin e shërbimeve te tilla si përgatitje faqe interneti, përgatitje reklamash, posterash, ftesash, kartvizitash, e deri në shtypje e lidhje libri. Kryerja e veprimtarive të tjera tregtare si shitja dhe blerja me shumicë dhe pakicë të artikujve të kancelarisë, pajisje elektrike dhe elektronike shtëpiake, etj

Realizimi i import-eksportit të të gjithë artikujve të përmendur më sipër.

Programim faqesh internet (ËebDesign-Development) si dhe mirembajtjen e tyre.

Tregtim të programeve informatike (softëareve), programim dhe zhvillim te aplikacioneve ëeb-based. Instalime mirëmbajtje paisjesh teknike, speciale (kaldaja,kondicionier, sistemet e ngrohjes, gjeneratore etj). Krijimi i dhomave serverash.



Shitje dhe dhënie me qira paisjesh monitorimi GPS dhe cdo aksesori të tyre. Shërbim monitorimi gps dhe cdo sensori për matje furnizimi dhe shpërndarjes së rrymës elektrike, furnizimi dhe shpërndarjes me ujë, furnizimi dhe shpërndarjes së naftës. Monitorim të konsumit dhe qarkullimit të karburantit me sistem gps.

Importi, tregtimi, instalimi, operimi, mirëmbajtja dhe çdo veprim tjetër që lidhet me impjante dhe panele diellore fotovoltaike.

Shitje, Servis dhe Mirembajtje pjesë këmbimi të ndryshme për Printera, Fotokopje, Skanera, Videoprojektor, Barcode Scanner, POS, Kompjuter, Laptop, Servera, Storage, Pajisje rrjeti, Ponitor, Ups, Bateri, Invertera, Rack, Sisteme Sigurie, Sisteme aksesori, Sisteme Antizjarri, etj. Zhvillim dhe Implementim Sistem Rradhe, Sisteme Infokioske, Dizajn dhe Zbatim Server Room, Datacenter, Call Center etj.

Dhënia me qera e Paisjeve Elektronike si Printer, Fotokopje, Desktop, Laptop, Server etj .

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

NENI 4 SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet në Fshatin Donofrose, Nj.A Cukalat, Bashkia Dimal, Berat.

NENI 5 TË NDRYSHME

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të zmadojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas parashikimeve të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

KREU II KAPITALI

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë dhe depozitohet në një llogari bankare të vecantë sipas përcaktimeve ligjore. Cdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri dhe pjesmarrja e ortakëve është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

Z. Besnik Hoxha zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë ose (një) kuotë në vlerë të barabartë 100.000)lekë



NENI 7 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 8 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të Shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) Shitblerjes së kuotave;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndërmjet ortakëve përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitla it janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

NENI 9 TË TJERA

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhen të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo Shoqëri dhe që u drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 10 ORGANI VENDIMARRËS

Organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të përshkruara si më poshtë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;



- b) ndryshimin e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “a” dhe “ç” të kësaj pike;
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshijnë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 11

MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLËSË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 12

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakoshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas Nenit 87 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3, të Nenit 88 të këtij Ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 13
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) Përcaktimin e shpërblimeve për likuiduesit dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve;
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

NENI 14
PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për :

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
- d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 15
ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga një administrator i cili caktohet në statutin e Shoqërisë dhe më pas nga vendimet e Asamblesë së Ortakëve. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë 5(pesë) vjecare me të drejtë riemërimi nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Në asnjë rast ortakëve nuk u dihet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorët. Nëçdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit.

Administrator i Shoqërisë është Z.BESNIK HOXHA

Nënshkrimi i Administratorit : _____

NENI 16
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d- të përgatisë dhe nëshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e- krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencës e shoqërisë;
- f- kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të regjistrimit;
- g- raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posceme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h- kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga në ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiar të certifikuar.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 17 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja qëi sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për ta përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përvec sa është në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas Neneve 14,15,17 e 18 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë e Tregtarët”, administrator detyrohet:

- a- Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- b- Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c- Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d- Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
- e- Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, të parashikuara, është i



detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin ngas kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara.

Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a- U kthen ortakëve kontributet;
- b- U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c- U shpërndan aktivet shoqërisë;
- d- Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, ku në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e- Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisohet ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

NENI 18

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 19

VITI FINANCIAR

Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 dhjetor.

NENI 20

EKSPERTËT

Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një eksperti. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në një lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzohet në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 21
PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet :

- a- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b- Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c- Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të Nenit 43 të Ligjit Nr.9273 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e- me vendim të gjykatës;
- f- për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Në rast se Shoqëria shpërndahet për cdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për c’regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Në rast se ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30- ditëve pas prishjes, çdo personi i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

NENI 22
RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes sëPërgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 23
BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotëme këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 24
MOSMARRËVESHJET

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin në lidhje më zbatimin apo intepretimin e këtj statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të Tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT E SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Ortaku i Shoqërisë:
BESNIK HOXHA

Besnik Hoxha
